



TV / interneti / telefoni

Për internet, telefon dhe televizor kabllor ka ofertues të ndryshëm. Ofertat janë pjesërisht prej vendbanimi të mvarura. Gati të gjithë banoret dhe banorët duhet të paguajnë taksa për radio dhe televizor.

Taksat për radio- dhe televizor

Nëse njeriu e ka në banesë një aparat, që i zë programet e radios dhe televizorit (edhe kompjuteri me lidhje për internet) duhet njeriu të paguaj taksat për radio dhe televizor (Radio und Fernsehgebühren). Me këto taksa të bëra me ligj mbështeten programet e radiove dhe televizionet publike (SRG SSR) si edhe radiot dhe televizionet private. Për marrjen e taksave është firma Serafe përgjegjëse. Personat që marrin shërbime shtesë nga shteti, mund të lirohen nga taksa.

Telefoni, interneti, televizori-kabllor

Për telefon, internet dhe televizor kabllor ka në Zvicër ofertues të ndryshëm. Disa janë në rajone të ndryshëm aktiv. Mvaret nga vendbanimi dhe pjesërisht edhe nga shtëpia se cilat ofera mund të shfrytëzohen. Krahësimi e vlen se shërbimet dhe çmimet janë të ndryshme. Kush don me pas një lidhje përmes satelitit duhet më parë qirradhënesin apo fqinjet dhe fqinjët t'i njoftoj. Lidhjet me internet te shtëpia zakonisht janë shumë të shpejta. Internetkafe ka shumë pak, pasi zakonisht të gjitha shtëpit janë të lidhura me internet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/banimitv--interneti--telefoni